



<b>Datë/a:</b>	27.08.2018
<b>Për/ Za/ To:</b>	Operatori Ekonomik: NTSH "AB - CLEAN"
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 27.08.2018 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: NTSH "AB - CLEAN", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të ri komunal dhe disa institucioneve tjera komunale", me Nr. të Prok: 616 18 80 221 nxjerr:

## V E N D I M

1. Aprovohet në tërësi si e bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik NTSH "AB - CLEAN", lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të ri komunal dhe disa institucioneve tjera komunale", me Nr. të Prok: 616 18 80 221, kundër *Njoftimit për dhënie të aktivitetit të AK - së*, të datës 23.08.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së.
2. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdojë me ri-vlerësimin e aktivitetit të prokurimit me titull "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të ri komunal dhe disa institucioneve tjera komunale", me Nr. 616-18-5073-2-2-1 Nr. Brendshëm 616 18 80 221 dhe mbështet aktivitetin e prokurimit për ri-vlerësim.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

## Ar sy e t i m

Autoriteti Kontraktues - Komuna e Prishtinës me datë 17.07.20178 ka bërë njoftimin për kontratë lidhur me tenderin me titull: "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të ri komunal dhe disa institucioneve tjera komunale", me Nr. 616-18-5073-2-2-1 Nr. Brendshëm 616 18 80 221.

Hapja e ofertave nga Autoriteti Kontraktues është bërë me datë: 06.08.2018 ku të pranishëm ishin Operatorët të cilët kanë ofertuar për këtë tender. Janë pranuar 6 oferta. Autoriteti Kontraktues ka respektuar të gjitha dispozitat ligjore të Ligjit për Prokurimin Publik lidhur me mbarë vajtjen dhe ecurinë e procesit të hapjes dhe vlerësimit të ofertave.

Me datë 23.08.2018, Autoriteti Kontraktues ka bërë njoftimin për dhënie të kontratës pas vlerësimit të ofertave nga ana e anëtarëve për Komision për Vlerësim ku secili anëtar ka dhënë vlerësimin e tij për çdo kriter të paraqitur në dosje.

Me datë 24.08.2018, Operatorit Ekonomik NTSH "AB - CLEAN", iu ka lejuar qasja në dokumentacion të të gjitha ofertave lidhur me këtë tender.

Operatori Ekonomik NTSH "AB - CLEAN", lidhur me aktivitetin e prokurimit "Mirëmbajtjen dhe pastrimin e objektit të ri komunal dhe disa institucioneve tjera komunale", me Nr. 616-18-5073-2-2-1 Nr. Brendshëm 616 18 80 221, kundër Njoftimit për dhënie të kontratës të aktivitetit të prokurimit të AK -së, të datës 23.08.2018 të publikuar në web-faqe të KRPP-së, ka bërë Kërkesë për Rishqyrtim me datë 27.08.2018 sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr.04/L-042, në të cilin pretendon:

a) *Pretendimi 1: Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar si duhet nenin 59 të LPP-së dhe nenin 41 të RRUOPP-së (Vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi) të Ligjit për Prokurimin Publik*

3. *Autoriteti kontraktues do të përmirësojë gabimet në një tenderë të cilat janë tërësisht aritmetike, nëse gabimet e tilla zbulohen gjatë ekzaminimit të tenderëve sidoqoftë ky përmirësim nuk mund të jetë më shumë se dy për qind (2%) i vlerës totale të ofertës. Në një rast të tillë, çmimi për njësi i ofertuar nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohet si çmim mbizotërues mbi çdo çmim tjetër kontradiktor. Kur nuk kërkohen çmimet për njësi, elementet e çmimit të vetëm të çmimit total të ofruara nga operatori ekonomik në tenderin e tij financiar gjithmonë do të konsiderohen si çmim mbizotërues mbi çmimin total.*

Autoriteti kontraktues menjëherë do ti dërgojë të gjithë tenderuesve përkatës një njoftim me shkrim mbi ndryshimet e tilla.

4. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Pavarësisht nga e mëparshmjja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspektin e tenderit në fjalë, ose (ii) përmban vetëm devijime të vogla që nuk mund të shkaktojnë ndryshime materiale ose devijime nga karakteristikat, kushtet, dhe kërkesat e tjera të parashtruara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit; me kusht që, çfarëdo devijimi i tillë të kuantifikohet, aq sa është e mundshme, dhe të merret parasysh gjatë vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues - KK Prishtinë, përmes Komisionit për vlerësimin, ekzaminimin dhe krahasimin e tenderit me vendimin e vet për të trajtuar ofertën e Kompanisë "MSS" si ofertë e përgjegjshme dhe si rrjedhojë e kësaj të marrë vendim për shpërbllim të kontratës, ka vepruar në kundërshtim me nenin 59, par.4 dhe 4 të LPP-së.

Duke u bazuar në formularin e tenderit me çmimin e tenderit në shifra është në hapje të tenderit 99.512,80 €.

Gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderit, AK ka zbuluar se oferta financiare e OE "MSS" ka gabime aritmetike në çmimin total të tenderit dhe si rrjedhojë e kësaj ka bërë korrigjimin e gabimit aritmetikor i cili pas korrigjimit sipas AK-së është në vlerë prej 101.512,80 €.

Nëse e llogarisim në përqindje të lejuar të korrigjimit prej 2% të vlerës totale të ofertës, do të shohim se vlera prej 9 € e tejkalon vlerën e lejuar me ligj.

Çmimi i tenderit pas korrigjimit të gabimit në total është më shumë se 2%. Pretendojmë se OE ka bërë gabim aritmetikor në totalin e njërive më shumë se 2%, përkatësisht 2,0097%.

Duke pasur parasysh këto fakte pretendojmë se AK-Komuna e Prishtinës ka vepruar në kundërshtim me paragrafin 3 të nenit 59 të LPP-së.

## **I. Baza ligjore për Aprovim të kërkesës.**

Autoriteti Kontraktues ka bërë vlerësimin e ofertave duke bërë ekzaminimin e të gjitha dokumenteve të prezantuara në ofertat e pranuar.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e ofertave ka zbatuar së pari nenin 6 (Parimi i Efikasitetit dhe Ekonomizimit) dhe nenin 7 (Parimi i Barazisë / jo diskriminimit) të Ligjit për Prokurimin Publik të konsoliduar me Nr. 04/L-042.

Autoriteti Kontraktues aprovon pretendimin e OE dhe gjithashtu konfirmon se KK Prishtina ka vlerësuar ofertat në përputhje me LPP-ne dhe është bërë gabim më se 2% të vlerës së ofertës nga OE "MSS" i propozuar për dhënie të kontratës nga çmimi i lexuar 99.512,80 € në korigjim të çmimit 101.512,80 € pra është bërë tejkalim i vlerës prej 9 euro nga 2.00097% diferenca e tejkualuar (0.97%)

**Autoriteti Kontraktues vendos që të bëjë ri-vlerësimin e ofertave sipas Kërkesës për Rishqyrtim në bazë të provave të prezantuara, dispozitave të LPP-së dhe RRUOPP-së.**

Andaj duke u bazuar në të gjitha provat dhe argumentet e prezantuara si dhe duke zbatuar dhe respektuar Ligjin për Prokurimin Publik, Rregullat e Udhëzuesit Operativ për Prokurimin Publik, Autoriteti Kontraktues vendos si në dispozitivin e cekur më lartë.

### **Këshilla juridike:**

*Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.*

**Zyrtari përgjegjës i Prokurimit**

